



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1670/1/Prot.

Tiranë, më 08/02/2018

Lënda: Përgjigje tuajës Nr.17, datë 05.02.2018.

Z. ENKELEJD ALIBEAJ
DEPUTET
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Në përgjigje të kërkesës drejtuar Ministrit të Drejtësisë në kuadrin e Interpelancës me objekt: "Raportimin në lidhje me procedurat e ekstradimit të shtetasit Nezar Seiti dhe masat e marra nga Ministri i Drejtësisë për Korrigjimin e shkeljeve ligjore eventuale", ju bëj me dije sa vijon:

a) Kopja e plotë e praktikës së ekstradimit të shtetasit Nezar Seiti, që ju kërkonte t'ju vihet në dispozicion është dokumentacion që për shkak të informacionit që përmban, është i klasifikuar në nivelin "sekret shtetëror" në bazë të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar.

Në zbatim të këtij Ligji dhe të Urdhrit të Ministrit Nr.2092/4, dt.22.11.2017 "Për Listën e dokumentave të klasifikuara "sekret shtetëror" në Ministrinë e Drejtësisë, strukturat në varësi të saj dhe godinat në administrim të saj", kopja e praktikës nuk mund t'ju vihet në dispozicion, pasi nga kërkesa juaj nuk rezulton të jenë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 21 i këtij Ligj për sa i përket të drejtës së njohjes së informacionit, i cili parashikon shprehimisht se:

Një person mund të njihet me një informacion të klasifikuar nëse ai siguron një të drejtë njohjeje nga një drejtues institucioni apo personi, të cilit me ligj i është deleguar një e drejtë e tillë, kur:

a) personi ka nevojë për njohje informacioni për përmbushjen e interesave dhe qëllimeve të ligjshme;

b) personi ka nënshkruar një marrëveshje për mosekspozimin e informacionit;

c) personi ka garanci sigurie;

ç) personi ka zotësi për të vepruar;

b) Së dyti, dosja apo çdo letërporosi e klasifikuar "sekret shtetëror" jo vetëm për këtë arsye por edhe për shkak të moscënimit apo paragjykimit të procedimit penal apo hetimeve të

SEKRET

kryera dhe që vijojnë, nuk mund të bëhen publike dhe rrjedhimisht nuk mund të jenë pjesë e diskutimit parlamentar apo vendimmarrjeve politike.

Për sa i përket kërkesës tuaj për vënien në dispozicion të kopjes së praktikave mbi procedimet nr. 313/2017 dhe nr.164/2017, nga verifikimet e kryera me këto të dhëna nuk rezulton të jetë sjellë ndonjë letërporosi nga Prokuroria e Përgjithshme apo Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë në Ministrinë e Drejtësisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)



SEKRET